

Mr. Lucija Gjurashković

Mbi kultin e Shën Shirgjit dhe Shën Bakut në Malin e Zi

Institucioni Publik „Muzeu dhe Galeritë e Budvës“

Abstrakti: Ky punim hap temën dhe jep udhëzimet bazë për mundësinë e aktualizimit të karakteristikave të caktuara të kultit të krishterë të Shën Shirgjit (Sergius) dhe Shën Bakut (Bacchus) në territorin e Malit të Zi, veçanërisht në rajonin e Adriatikut Juglindor. Qëllimi dhe synimi i këtij hulumtimi është që, përmes përzgjedhjes dhe valorizimit turistik të vendeve të shenjta më të rëndësishme të shenjtoreve të përmendur, aplikimet teorike, të cilat përqendrohen në kultin e lartpërmendur në Bregdetin e Malit të Zi, të shndërrohen në kornizën për realizimin e projektit konkret turistik në zonën ndërkufitare të Malit të Zi dhe Shqipërisë, e cila në kohën e krishterimit të hershëm kishte karakteristika të veçanta hapësinore dhe historike. Hipoteza metodologjike bazë e punimit është përshkrimi i shumicës së monumenteve sakrale ose të mbetjeve të tyre në bregdetin malazez, e që i kushtohen Shën Shirgjit dhe Shën Bakut, analizës së kuptimeve të tyre kulte dhe lidhjes e tyre me zgjidhjet heuristike nga fusha e turizmit fetar (pelegrinazhit). Nënkuptohej që ekziston një tendencë të provohet mundësitë e reja për zhvillimin dhe përmirësimin e turizmit kulturor. Monumentet sakrale kushtuar Shën Shirgjit dhe Shën Bakut, si dhe afirmimi i kultit të tyre, paraqesin potencial kulturor me rëndësi të veçantë, i cili kërkon mbrojtje, prezantim të përshtatshëm dhe pozicionim të veçantë në ofertën kulturore dhe turistike. Kështu do të pihen kushtet për mundësitë tjera dhe ndryshe për zhvillimin dhe përmirësimin e turizmit fetar, si segment të turizmit kulturor, por edhe të valorizohet dhe afirmohet trashëgimia kulturo-historike.

Fjalët kyçe: historia, krishterimi, kulti, kultura, arti, arkitektura, tempulli, Shën Shirgji dhe Shën Baku, Bregdeti malazez, trashëgimia kulturore, valorizimi turistik

Në kulturën e krishterë, nocioni i kultit personifikon njërën nga çështjet më komplekse ndërdisiplinore, duke pasur parasysh se është objekt i studimeve në fushën e etnologjisë, sociologjisë

kulturore, antropologjisë, teologjisë dhe historisë së artit. Kur flas për kompleksitetin e kësaj çështjeje, kam parasysh shumëllojshmërinë e qasjeve që kanë autorët e ndryshëm ndaj këtij problemi, në varësi nga shkollat dhe drejtimit metodologjike që ato i përkasin. E theksoj këtë për shkak të mospërputhjeve ose kontradiktave të shpeshta që hasja gjatë përkufizimit të këtij nocioni. Prandaj, çështja thelbësore këtu është prej çfarë përbëhet dhe nga rrjedhë përkufizimi themelorë i këtij fenomeni. Nga ana etimologjike, fjala kult rrjedh nga fjala latine **cultus**, e cila është një formë e foljes **colere**, që do të thotë "të kremtosh" ose të adhurosh hyjninë. Te politeistët, **Cultus** ishte një fjalë e përgjithshme që nënkuptonte kremtimin, pavarësisht për cilin Zot bëhet fjalë. Vulgata, përkthimi latin i Biblës, e përdor këtë fjalë në kuptimin e përgjithshëm të kremtimit, pavarësisht se kujt hyjni i referohet, gjë që, për shembull, e konfirmon citati nga Veprat e Apostujve (17:3-25). Kjo fjalë përdoret gjithashtu në tekstet e hershme të krishtera që flasin për adhurimin e një Zoti të vërtetë. Pra, në krishterim nocioni i kultit rrjedh nga shenjtëria që ka zanafillën te Jezu Krishti. Themeli teologjik skajor i fenomenit "ata që janë më afër Zotit", natyrisht, gjendet në mësimet e Dhiatës së re për komunitetin e të shenjtëve dhe trupin mistik të Krishtit, por edhe në vet natyrën e kishës.

Pikërisht raporti ndaj kuptimit dhe ruajtjes së konceptit të shenjtërit mbrojtës të familjes ose të komunitetit më të gjerë, do të ndikonte në vendosjen e një marrëdhënie specifike me shenjtërin, kulti i të cilit do të shtrihet gjerësisht dhe mishërisht përgjatë historisë. Sipas kësaj,

është e rëndësishme të nënvizohet se në formimin e kultit të një shenjtori të caktuar ndikon edhe numri i monumenteve sakrale të ndërtuara në një hapësirë të caktuar, mrekullibërja e ikonave, si dhe madhësia e familjeve që shënojnë kremten kushtuar shenjtorit në fjalë.



Afresku i Shën Shirgjit dhe Shën Bakut

Kulti i Shën Shirgjit (lat. Sergius) dhe Shën Bakut (lat. Bacchus) erdhi në trevat e Adriatikut Jugor, respektivisht në zonën bregdetare të Malit të Zi, kryesisht nëpër det, dhe më pas nga Kostandinopoja dhe Dardania (Ballkani Qendror). Numri i kishave të zbuluara kushtuar këtyre shenjtorëve dëshmon për rëndësinë që kishte kulti i këtyre shenjtorëve në mesjetë, veçanërisht në hapësirat tona. Në lartësimin e kultit të tyre kontribuoi dukshëm edhe fakti që eshtrat e këtyre shenjtorëve ruhen në manastirin Milesheva (mne. manastir Mileševa) (përmes Shën Savës nga pelegrinazhi i tij në Siri dhe Antiokia¹). Megjithatë, edhe para këtyre kohëve kulti i Shën Shirgjit dhe Shën Bakut ishte aktivisht i pranishëm dhe konsiderohet si një nga kultet më të hershme të krijuara në këto treva, duke pasur parasysh në veçanti zonën e Adriatikut Jugor (nga Dubrovniku deri në Shkodër në jug) e cila, bazuar në të gjithë treguesit, është kyç për studimin e kultit të këtyre shenjtorëve, sepse këtu është koncentruar numri më i madh i kishave, sipas të dhënave të ruajtura më shumë se 15, por edhe i popullsisë që kremton Ditën e Shën Shirgjit (mne. Srđevdan) si festë të shenjtorit mbrojtës. Për shembull, deri në vitin 972, Shën Shirgji dhe Shën Baku ishin shenjtorët – mbrojtësit e qytetit të Dubrovnikut. Migrimi dhe

shpërngulja nga këto treva me shekuj e ka përhapur kremten e Shën Shirgjit në vende tjera, kështu që, krahas rajoneve tjera më të vogla, Mali i Zi me Bregdet konsiderohen si zonë ku kulti i këtyre shenjtorëve ishte i zhvilluar ndjeshëm. Urdhri Benediktin luajti një rol të veçantë në përhapjen dhe lartësimin e këtij kulti.

Shirgji dhe Baku jetuan në kapërcyellin midis shekullit III e IV, në kohën e reformave të Perandorisë Romake dhe persekutimit të madh të krishterëve nga perandori Dioklecian (sundoi nga viti 286 deri në vitin 305). Ishin oficerë të legjioneve kufitare të ushtrisë romake në provincën siriane *Augusta Euphratensis*, në zonën kufitare drejt shtetit persian Sasanida. Për shkak se ishin të krishterë, Sergji dhe Baku u vranë nga perandori Maksimin Daja (Gaius Galerius Valerius Maximianus, 305-311), një nga katër bashkësundimtarët-tetrark të Perandorisë Romake. Atyre iu hoqën shenjat ushtarake dhe të veshur me rroba grash u shoqëruan nëpër rrugët e qytetit (me gjasë bëhet fjalë për qytetin Arabis-Arabissus në Kapadokia, Azia e Vogël), që ishte një mënyrë e zakonshme për të turpëruar ushtarët. Pas kësaj, ata u dërguan te guvernatori i Antiokisë, i cili urdhëroi të torturohen dhe të vriten: Baku u kamxhikua për vdekje në qytetin *Barbalissus*, ndërsa Shirgji u gozhduar në një dërrasë në këmbë dhe kështu duhej të ecte deri në rraskapitje. Atij përfundimisht iu pre koka në qytetin Resaf (Rosaf, Rasafa) në Siri, në vitin 305. Qyteti Resaf (në arabisht Ar-Rasafeh) u themelua diku në shekullin IX para Krishtit, si një kamp ushtarak i asirianëve. Në periudhën romake dhe bizantine, personifikonte një fortifikatë të fortë drejt kufirit me Persianët. Mrekullitë e shpeshta që ndodhnin në Resaf, rreth varrit të Shën Shirgjit dhe Shën Bakut, si dhe të Shën Justinës, një martire e krishterë që ka shumë të ngjarë të ishte varrosur në të njëjtin vend, e bëri atë qytet një nga vendet më të rëndësishme për pelegrinazh gjatë krishterimit të hershëm. Gërmimet arkeologjike kanë vërtetuar se në vitin 425 Resafi ishte tashmë qendra e kultit të Shën Shirgjit, i cili ishte shumë i përhapur dhe i respektuar në Lindje deri në pushtimet arabe në shekujt VII dhe VIII. Fisi i krishterë arab Taglib (Taghlib) kishte Shën Shirgjin dhe Shën Bakun në flamurin e vet, kurse një grup fisesh nomade *Banu Ghassan* nderuan Shën Shirgjin, ose Sarkisin në arabisht, si mbrojtësin e tyre.

¹ Shih: R. M. Grujić, *Sv. Sava i mošti Sv. Srđa i Vakha*, Glasnik Skopskog naučnog društva, knj. 15-16, Skoplje, 1936.

Një nga admiruesit më të mëdhenj të Shën Shirgjit ishte *Khosrow II* (590-628), mbreti sesanid i Persisë, i cili besonte se Shën Shirgji e ndihmoi disa herë. Nga shekulli IV dhe njohja e krishterimit si religjion zyrtar, Resafi dhe kulti i Shën Shirgjit dhe Shën Bakut marrin një rëndësi të madhe në Perandorinë Romake të vonë, gjegjësisht në Bizantin e hershëm. Së shpejti, në vitin 434, Resafi ndryshoi emrin e tij në Sergiopolis dhe u bë selia episkopale në të cilën, gjatë sundimit të perandorit Justinian (527-565), në vitin 559 u ndërtua një kishë madhështore kushtuar Shën Shirgjit dhe Shën Bakut. Kishat kushtuar këtyre shenjtorëve, Justiniani i ndërtoi edhe në Kostandinopojë dhe qytetin Akra, që dëshmon për lartësimin e këtij kulti në periudhën e krishterimit të hershëm. Shën Shirgji dhe Shën Baku u bënë edhe një nga mbrojtësit e ushtrisë bizantine, kurse qyteti Resaf dhe kisha me varrin dhe eshtrat, një nga vendet më të mëdha të pelegrinazhit në të gjithë Lindjen. Nën sulmin e persëve në shekullin e VII dhe më pas të arabëve në shekullin e VIII, kisha në Resaf u dëmtua shumë, kurse nën trusninë në rritje të Islamit, krahas me tërheqjen e krishterimit, venitet edhe kremtimi i kultit të Shën Shirgjit dhe Shën Bakut në atë hapësirë.

Duke gjykuar nga numri i kishave kushtuar Shën Shirgjit dhe Shën Bakut në bregdetin dhe brendësinë e Adriatikut Jugor, këta shenjtorë gjatë tërë mesjetës u respektuan dhe kremtuan në këto treva (u kremtuan si festë e shenjtorit mbrojtës / më 7 tetor sipas kalendarit të vjetër ose më 20 tetori sipas kalendarit të ri). Pas lartësimit dhe zhvillimit të këtij kulti në Siri në periudhën nga shekulli IV deri në shekullin VII, ai gradualisht u dobësua nën ndikimin e Islamit, megjithëse disa zakone që lidhen me nomadët shkretinor me orientim të krishterë do të mbeten edhe sot e kësaj dite. Në kohët e mëvonshme të mesjetës, por edhe më vonë, krahina e Ballkanit Perëndimor do të jetë një qendër e fortë e zhvillimit dhe mirëmbajtjes së këtij kulti. Përmendja më e vjetër e kremtimit të këtij kulti konsiderohet të jetë ajo në Bulën e Papa Aleksandrit II, në vitin 1067 „*sanctorum Sergii et Bachi*”.²



Mbetjet e kishës së Shën Shirgjit dhe Shën Bakut

Kishat më të rëndësishme në Malin e Zi që lartësojnë kultin e këtyre shenjtorëve janë: Kisha e Shën Shirgjit dhe Shën Bakut pranë Shkodrës mbi Bunë, ku u varrosën sundimtarët e Zetës nga dinastia Vojislavleviq në shekujt XI dhe XII, dhe kisha e Shën Shirgjit dhe Bakut në Podi afër Herceg Novit (nuk ka të dhëna të shkruar për kohën e ndërtimit të saj). Kur bëhet fjalë për të parën, supozohet se në zonën përreth Shkodrës (bregu i majtë i lumit Buna), edhe para ndërtimit të këtij objekti, ka ekzistuar një tempull kushtuar këtyre shenjtorëve të periudhës së Justinianit (shekulli VI). Më vonë, kulti do të përhapet ngabenediktinët, kështu që, sipas studiuesve të caktuar, kisha, në periudhën e shekullit XI, ishte pjesë e manastirit të tyre. Si dëshmi e respektit të jashtëzakonshëm që gëzonin këta shenjtorë dëshmon fakti se kisha e Shën Shirgjit dhe Shën Bakut është bërë varrezë familjare e dinastisë së mbretërve të Duklasë. Duke respektuar lashtësinë dhe rëndësinë e kësaj kishe, mbretëresha Jelena Anzhuine, me djemtë e saj, Dragutinin dhe Millutinin, ndërtoi një të re në vitin 1290, mbi themelet e së vjetrës. Ishte objekti më i madh sakral në territorinë e Kryepeshkëvisë së Tivarit. Fatkeqësisht, për shkak të pozitës së manastirit dhe dëmtimit të tij nga lumi Bojana, por edhe të sulmeve turke në shekullin XVI, nga kisha dhe manastiri mbeten vetëm gjurmët e rrënojave. Në literaturë ky objekt përmendet edhe si kisha e Shën Shirgjit në Obot, kurse për rëndësinë e kultit të Shën Shirgjit dhe Shën Bakut në zonën e Shkodrës tregon edhe fakti se ky qytet, duke filluar nga viti 1215, filloi të quhej Rosaf, sipas qytetit në Siri, ku Shirgji u vra në fillim të shekullit të IV dhe nga ku u përhap në Perandorinë

² Istorija Crne Gore, *Od najstarijih vremena do XII vijeka*, tom I, Titograd 1967, str. 441

Romake nderimi i këtij shenjtori. Kisha për herë të parë përmendet në Kronikën e Papa Duklaninit, ndërsa informacionet e para të besueshme për të i jep historiani Jastrebov në *“O pravoslavnim srpskim starim i novim crkvama u Staroj Zeti”* (sot Qarku i Shkodrës), botuar më 1879 në *„Podatci za istoriju srpske crkve”*³.

e turizmit të pelegrinazhit, e rrjedhimisht edhe atij kulturor.



Kisha e Shën Shirgjit dhe Shën Bakut në Podi pranë Herceg Novi

Për zhvillimin e kultit të këtyre shenjtorëve në brezin bregdetar të Malit të Zi janë të rëndësishme edhe kishat: kisha e vjetër, e përmendur tashmë, e Shën Shirgjit dhe Shën Bakut në Podi afër Herceg Novit (kisha e sotme daton nga fundi i shekullit XIV ose fillimi i shekullit XV), kisha e Shën Shirgjit në Tivat (nga shekulli XI), kapela e Shën Shirgjit dhe Shën Bakut në Stonsko Pole, si dhe shumë kisha dhe kapela të tjera (veçanërisht në territorin e Kotorrit).

Për shkak të migrameve të shpeshta, sot kremtimi i Shën Shirgjit dhe Shën Bakut lidhet vetëm me zonat e caktuara, më të vogla, në Malin e Zi, dhe pjesërisht në Kroaci, Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë. Veçanërisht bujqit janë të kujdesshëm që gjatë Ditës së Shën Shirgjit të mos dalin me qe në fushë, sepse, siç thotë populli, atë ditë nuk është mirë të lëvrohet. Besohet gjithashtu se atë ditë zbuten edhe kafshët e egra.

Duke pasur parasysh të lartëpërmendurat, krahas rajoneve tjera më të vogla, Mali i Zi me Bregdet mund të konsiderohen si një zonë ku kulti i këtij shenjtori u zhvillua ndjeshëm, prandaj edhe sot ofron mundësi të shumta për zhvillimin

³ Shih: И.С. Јастребов, *Подаци за историју српске цркве*, Београд 1879, 143-176.